

**PROCES- VERBAL Nr. 2**

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURËS NË NJË KONTRATË  
(PA LOTE )**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Shërbim sigurie i ruajtjes fizike të ndërtesave, aseteve, dhe njerëzve të Drejtorisë Rajonale të OSSH sh.a, Berat & FSHU sh.a, Berat” - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
79713000-5, 66515000-3

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 142, 729, 982 (njëqind e dyzetë e dy milion e shtatëqind e njëzetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH, Berat, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e mosndarjes së procedurës në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Referuar specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojca 5, të DST-së:

- *Sherbimi i ruajtjes fizike do të fillojë në orën 08:00 në mëngjes, do të mbarojë në orën 16:00 për shërbimin 8 orë dhe në orën 20:00 në darkë për shërbimin 12 orësh. Sherbimi do të ofrohet nga e Hëna në të Shtunë.*
- *Sherbimi i ruajtjes me sistem alarmi do të ofrohet nga ora 16:00 deri në orën 08:00 në vendet ku shërbimi i ruajtjes fizike do të ofrohet 8 orë dhe nga ora 20:00 deri në orën 08:00 në vendet ku shërbimi i ruajtjes fizike do të ofrohet 12 orë, 24 orë ditët e pushimeve dhe festat zyrtare.*

Referuar Formularit të Sherbimit dhe grafikut në Shtojca 6, të DST-së:

*Sherbimi me roje private do të kryhet në disa qytete, në njësi dhe agjensi të cilat janë të gjitha në varesi të Drejtorisë Rajonale të OSSH sh.a, Berat & FSHU sh.a, Berat.*

Ndarja në lote sipas qyteteve do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë. Kjo do të sillte kosto të shtuara për AK si edhe risk dhe veshtiresi për autoritetin kontraktor gjatë zbatimit të kontratës. Kontrolli për verifikimin nëse shërbimi do ofrohet sipas specifikimeve teknike do të komplikojë edhe më shumë. Ndarja në lote do të

---

komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 prashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.  
Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.
3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriteve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. *Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*
  2. *Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.*
-

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Theksojmë se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të pasi ndikon drejtperdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që në thelb shërbimi është i së njëjtës natyrë. Në këto kushte, gjukojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Akoma më tej, legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetem paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik e njeh të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

**Pra duke parë natyrën, specifikat dhe përmasën e këtij shërbimi, mënyrën e funksionimit të Drejtorisë Rajonale të OSSH, Berat sh.a që këtë shërbim e menaxhon nga një strukturë e veçantë e specializuar prane kesaj drejtorie do të përbënte një kosto të shtuar për institucionin tonë në ngritjen e strukturave të tjera çka do ta bënte të pamundur për realizimin e këtij shërbimi në kostot që do të shtoheshin institucionit tonë ndarja në lote.**

**Vendosëm mos ta ndajmë në lote sepse mendojmë se nëse një operator e fiton të gjithë kontratën, ai bazuar në parimin e ekonomisë së shkallës do mund të japi një ofertë ekonomike më të ulët dhe do mund të kursejmë të ardhura publike më shumë.**

**Për problemet që mund të lindin eventualisht gjatë zbatimit të kontratës, AK do i duhej të zgjidhte mosmarrëveshjet me dy ose më shumë operatorë dhe kjo mund ta vështirësonte zbatimin e kontratës**

---

**Ka shume vite qe kjo procedure realizohet e pa ndare ne lote, me te njejtat institucione dhe vendroje qe eshte edhe kete vit dhe sherbimet jane kryer me sukses, pa asnje problem.**

**Gjithashtu te njejtin qendrim ka mbajtur dhe Komisioni i Prokurimit Publike me Vendimin e tij Nr. 154/2017, i cili citon si me poshte:**

III.3.2. Sipas përgjigjes së autoritetit kontraktor, dhënë ankimesit nëpërmjet shkresës nr. 966/6 prot., datë 23.02.2017, është sqaruar si vijon:

*“Lidhur me pretendimin për ndarjen e procedurës në lote, sipas qarqeve: Ndarja në lote sipas qarqeve do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive. Kjo do të sillte kosto të shtuara për autoritetin kontraktor si dhe risk e vështirësi për AK-në gjatë zbatimit të kontratës. Kontrolli për verifikimin nëse shërbimi do të ofrohet sipas specifikimeve teknike do të komplikohet edhe më shumë. Ndarja në lote do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës. [...] Referuar rregullave të prokurimit publik, për realizimin e objektit të prokurimit mund të krijohen bashkime të përkohshme operatorësh ekonomikë të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme. Në varësi të degëve që do të marrin përsipër të mbulojnë me shërbimin e ruajtjes me roje private, përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes dhe elementët konkretë që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi [...].*

12

III.3.3. Në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VIII, neni 74, është parashikuar:

*1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.*

*2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës.*

*Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*

*3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

*Sa më sipër, për realizimin e objektit të prokurimit mund të krijohen bashkime të përkohshme operatorësh ekonomikë, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme. Në varësi të degëve që do të marrin përsipër të mbulojnë me shërbimin e ruajtjes me roje private, përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes dhe elementët konkretë që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi. Çdo anëtar i grupit duhet të përmbushë kërkesat e përgjithshme për kualifikim, ndërsa kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato*

---

teknike duhet të përmbushen në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në kryerjen e shërbimit në fililet/filialin përkatës, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se legjislacioni i prokurimit publik e njeh të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për kohësisht për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

**Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.**

## **Vendim i KPP-se 2015/2016**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Dea Security” sh.p.k, për ndarjen në lote më vete objektet me vendndodhje qarkun Berat dhe objektet me vendndodhje qarkun Fier, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7 Kapaciteti teknik dhe profesional, është kërkuar: “Për numrin e punonjësve të çertifikuar për jo më pak se 35, shoqëruar me listën emërore të tyre, të çertifikuar nga DPQ Berat dhe nga DPQ Fier”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që shërbimi të realizohet në 2 qarqe (Berat dhe Fier).

III.1.3. Autoriteti kontraktor në informacionin e sjellë e ka argumentuar këtë kërkesë me faktin se ndarja në lote do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive.

Kjo do të sillte kosto të shtuara për AK si edhe risk. Për problemet që mund të lindin eventualisht gjatë zbatimit të kontratës, AK do i duhej të zgjidhte mosmarrëveshjet me dy ose më shumë operatorë dhe kjo mund ta vështirësonte zbatimin e kontratës. Kontrolli për verifikimin nëse shërbimi po ofrohet sipas specifikimeve teknike do të komplikohet edhe më shumë. Ndarja në lote do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës.[...] Ky prokurim prokurohet pa lote për shkak se të gjitha objektet që do të ruhen janë në varësi të Drejtorisë Rajonale të OSHEE Berat. Njësitë Lushnje ku ndodhen një pjesë të vendrojave është në varësi të Drejtorisë Rajonale të OSHEE Berat.....

Vendosëm mos ta ndajmë në lote sepse mendojmë se nëse një operator e fiton të gjithë kontratën, ai bazuar në parimin e ekonomisë së shkallës do mund të japi një ofertë ekonomike më të ulët dhe do mund të kursejmë të ardhura publike më shumë.

III.1.4. Në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VIII, neni 74, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës.

5

Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë

*edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.*

*3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

*Sa më sipër, për realizimin e objektit të prokurimit mund të krijohen bashkime të përkohshme operatorësh ekonomikë, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme. Në varësi të degëve që do të marrin përsipër të mbulojnë me shërbimin e ruajtjes me roje private, përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes dhe elementët koktrete që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.*

*Çdo anëtar i grupit duhet të përmbushë kërkesat e përgjithshme për kualifikim, ndërsa kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në kryerjen e shërbimit në fililet/filialin përkatës, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

*Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se legjislacioni i prokurimit publik e njeh të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar përkohësisht për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.*

**Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.**

## **NJËSIA E PROKURIMIT**

- |                 |                    |
|-----------------|--------------------|
| - Armando Roko  | Personi përgjegjës |
| - Aldora Dume   | Anëtare            |
| - Bledar Dautaj | Anëtar             |